VENDIM
Nr.18, datë 23.4.2010

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar	i Gjykatës	Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar	i “	“
Kujtim Puto	Anëtar	i “	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i “	“
Petrit Plloçi	Anëtar	i “	“
Vitore Tusha	Anëtare	e “	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i “	“
Sokol Berberi	Anëtar	i “	“
Admir Thanza	Anëtar	i “	“

me sekretare Blerina Çinari, më datë 26.11.2009, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr.26/15 Akti, që i përket:

KËRKUES: GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR POGRADEC

SUBJEKTE TË INTERESUARA :

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga z.Lulzim Lelçaj.

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga znj.Marsida Xhaferllari.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE, përfaqësuar nga z.Endri Pema.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën, i pikës 5 të nenit 289 të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 134/1, d,145/2 të Kushtetutës, nenet 6 e 13 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe nenet 68, 69, 70 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vladimir Kristo; shqyrtoi pretendimet e kërkuesit; pretendimet e subjekteve të interesuara, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (Kuvendi), Këshilli i Ministrave (KM) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të cilët kërkuan rrëzimin e kërkesës dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Shtetasit M.Gj dhe B.B, në datën 14.12.2003, nëpërmjet pikës doganore të Tushemishtit, kanë importuar nga Republika e Maqedonisë një sasi malli të padeklaruar në autoritetet doganore të kësaj pike.

Në datë 16.10.2008, pas verifikimeve të kryera, Dega e Doganës Pogradec ka nxjerrë vendimin nr. 55, sipas të cilit shtetasit M.Gj dhe B.B, bazuar në nenet, 102, 217, 228, 256/4, 281/1, b të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë janë detyruar të paguajnë shumën prej 96 370 lekë, si detyrim doganor i munguar dhe janë dënuar me gjobë në masën 289 110 lekë (sa trefishi i detyrimit doganor), duke çuar detyrimin e përgjithshëm ndaj Degës së Doganës Pogradec në masën 385 480 lekë.

Sipas akteve rezulton se shtetasit kanë marrë njoftim për vendimin e sipërpërmendur në datën 04.11.2008.

Në datën 5.11.2008, shtetasit e lartpërmendur kanë ankimuar vendimin nr.55, datë 16.10.2008 të Degës së Doganës Pogradec te Drejtori i Përgjithshëm i Doganave.

Ky i fundit, me shkresën nr.prot 13441/1, datë 26.11.2008, e ka kthyer ankimin pa veprim pasi nuk përmbushte kushtin e përcaktuar në nenin 289/3 të Kodit Doganor, sipas të cilit shtetasi për të pasur të drejtën e ankimit pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave duhet të shlyente fillimisht detyrimin doganor të munguar, si dhe 40% të masës së gjobës së vendosur nga autoritetet doganore.

Në datën 5.11.2008 shtetasit M.Gj dhe B.Bazelli kanë depozituar në favor të Degës së Doganës Pogradec gjithë shumën e detyrimit doganor të munguar, si edhe 40% të vlerës së gjobës së vendosur nga autoritetet doganore, në shumën prej 212 014 lekë.

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave pas depozitimit të shumës së lartpërmendur, mori në shqyrtim ankimin dhe nëpërmjet shkresës nr. Prot 13441/5, datë 19.01.2009 njoftoi shtetasit e lartpërmendur se kishte vendosur të linte në fuqi vendimin e Degës së Doganës Pogradec.

Në datën 6.04.2009 shtetasit M.Gj dhe B.B i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec me kërkesëpadinë me objekt: “Konstatim i pavlefshmërisë absolute të vendimit nr.55, datë 16.10.2008 të Degës së Doganës Qafë-Thanë Pogradec, si dhe shfuqizimin e tij duke rregulluar pasojat”.

Gjatë gjykimit, pala e paditur, Dega e Doganës Pogradec, ka kërkuar rrëzimin e kërkesës për arsye se paditësit nuk kishin plotësuar kushtin e përcaktuar në nenin 289/5 të Kodit Doganor, sipas të cilit, për të pasur akses në gjykatë ndaj një mase administrative të autoriteteve doganore, duhet të shlyenin plotësisht vlerën e mbetur prej 60 % të gjobës.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, në datë 22.06.2009 vendosi pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjes pranë Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së pikës 5 të nenit 289 të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë, në të cilin thuhet: “Nëse ankesa nuk pranohet, apeluesi duhet të paguajë pjesën që mbetet prej 60 për qind të gjobës, dhe mund të ankohet kundër vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm pranë autoriteteve gjyqësore brenda 30 ditësh nga data e njoftimit të mospranimit të ankesës.”

II

1. Pretendimet e kërkuesit

Gjyqtari i vetëm i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, kërkesën e tij për kontrollin e kushtetutshmërisë së nenit 289/5 të Kodit Doganor, e ka mbështetur në argumentet e mëposhtme:

-Duke pasur parasysh se e drejta për një proces të rregullt ligjor është një e drejtë themelore kushtetuese, sanksionuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (më poshtë KEDNJ) dhe se e drejta e aksesit është një përbërës thelbësor i kësaj të drejte, Kuvendi, gjatë miratimit të ligjit, nuk ka marrë parasysh parimin e proporcionalitetit, parashikuar në nenin 17 të Kushtetutës, pasi detyrimi për të paguar trefishin e detyrimit doganor, i vendosur në formën e sanksionit administrativ, është i lartë dhe aspak i arsyeshëm.

-Shtetasit, për të përfituar të drejtën e aksesit në gjykatë, vihen në pozitë mjaft të vështirë financiare si pasojë e parapagimit të detyrimit doganor të munguar dhe sanksionit administrativ, pozitë që mund të shkojë deri në falimentim.

-Parashikimi i një procedure ankimi me pasoja kaq të rënda financiare mund të shërbejë si faktor frenues për t’iu drejtuar gjykatës, duke e kthyer ankimin gjyqësor në një mjet mbrojtës jo efektiv.

-Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (neni 42/2) dhe KEDNJ (nenet 6 dhe 13) njohin dhe garantojnë të drejtën e aksesit në gjykatë, qoftë si element i procesit të rregullt ligjor, qoftë si e drejtë për një ankim efektiv.

-Në kundërshtim me aktet e sipërpërmendura, të cilat nga pikëpamja hierarkike qëndrojnë më lart edhe se ligjet e miratuara me shumicë të cilësuar nga Kuvendi, pika 5 e nenit 289 të Kodit

Doganor jo vetëm që kufizon në mënyrë jo proporcionale të drejtën e aksesit në gjykatë të individëve, por cenon dhe vetë thelbin e kësaj të drejte, duke shkelur kështu nenin 17 të Kushtetutës.

-Kufizimi që i bëhet të drejtës për gjyq nga paragrafi 5 i nenit 289 të Kodit Doganor tejkalon haptazi kufizimet e vendosura nga nenet 6 dhe 13 të KEDNJ, të interpretuara nga jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

2. Përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, Kuvendi, Këshilli i Ministrave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, kërkuan nga Gjykata Kushtetuese rrëzimin e kërkesës, duke pretenduar:

A. Përfaqësuesi i Kuvendit të Shqipërisë

Gjyqtari, në kërkesën e tij për kontrollin e kushtetutshmërisë së nenit 289/5 të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë, nga pikëpamja formalo-juridike, nuk ka paraqitur asnjë argument lidhur me pamundësinë objektive për t`i dhënë zgjidhje çështjes konkrete, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Mungesa e këtyre argumenteve bën që të mos ekzistojë ajo lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet dispozitës së prezumuar si antikushtetuese dhe zgjidhjes së çështjes konkrete, lidhje kjo e konsideruar si kusht i domosdoshëm për të ushtruar kontrollin incidental nga vetë jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese.

Dispozita e cilësuar nga ana e gjyqtarit të vetëm *prima facie* si antikushtetuese nuk është kundërshtuar nga asnjë nga palët në proces.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec ka pranuar pretendimin e paditësve në lidhje me pamundësinë objektive për të paguar detyrimet doganore pa kryer asnjë lloj verifikimi në lidhje me këtë pamundësi, duke tejkaluar kompetencat e veta dhe duke u barazuar me subjektet të cilat, në përputhje me nenin 134 të Kushtetutës, kanë të drejtë të ushtrojnë kontroll kushtetues abstrakt të normave ligjore.

Edhe pse gjyqtari i vetëm nuk ka kufizime kohore për të ushtruar kontrollin incidental, në rastin konkret, prej këtij të fundit, është kontestuar një normë për zbatimin e së cilës ekziston një praktikë gjyqësore e konsoliduar në kohë, praktikë në të cilën përfshihen edhe qëndrime konstante të Gjykatës së Lartë.

Vjelja e detyrimeve doganore dhe lufta ndaj fenomenit të kontrabandës përbëjnë interesa të rëndësishëm publikë dhe si të tillë justifikojnë kufizime të së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës.

Në rastin e nenit 289/5 të Kodit Doganor kemi të bëjmë me një kufizim plotësisht të proporcionuar me gjendjen që e ka krijuar, në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

E drejta për akses është e pakufizuar në momentin e ekzekutimit të detyrueshëm dhe, për këtë arsye, nuk jemi para një kufizimi real të aksesit në gjykatë.

B. Përfaqësuesi i Këshillit të Ministrave

Lidhur me legjitimimin, gjyqtari i vetëm, duke pezulluar gjykimin dhe duke dërguar çështjen para Gjykatës Kushtetuese me qëllim ushtrimin e kontrollit të kushtetutshmërisë së nenit 289/5 të Kodit Doganor, ka tejkaluar kompetencat e veta, pasi kontrolli incidental mund të ushtrohet nga gjyqtari vetëm gjatë shqyrtimit të një çështjeje konkrete dhe jo kur një padi nuk plotëson kushtet formale ose substanciale për t'u marrë në shqyrtim nga gjykata;

Mjeti i kontrollit incidental nga ana e gjykatave të zakonshme mund të përdoret prej këtyre të fundit vetëm në rastet kur pengesa e paraqitur nga kushtetutshmëria e normës ka të bëjë me vendimin që do të merret në rastin konkret nga gjykata. Si rrjedhim gjyqtari mund të pezullonte gjykimin vetëm në rast se do vihej në diskutim kushtetutshmëria e një norme ligjore që do të kishte ndikim në vendimin për shpalljen e aktit administrativ si të vlefshëm ose të pavlefshëm dhe jo si në rastin konkret kur dispozita ka të bëjë me vazhdimin apo jo të gjykimit;

Këshilli i Ministrave pretendon se norma e kontestuar është në përputhje të plotë me nenin 17 të Kushtetutës, pasi përmban një kufizim të vendosur me ligj, për të përmbushur një interes publik, është në përputhje me gjendjen e krijuar dhe si i tillë nuk cenon thelbin e së drejtës

së ankimit dhe as nuk tejkalon kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut;

Kodi Doganor është hartuar me asistencën e përfaqësuesve të Komisionit Europian në Shqipëri (Misionit CAM-Albania) dhe, për rrjedhojë, është në përputhje me standardet bashkëkohore europiane.

C. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

-Vjelja e detyrimeve doganore dhe të ardhurave të tjera buxhetore (penaliteteve), si një atribut tipik i administratës doganore, është një element i rëndësishëm me interes të gjerë publik, pasi mundëson realizimin e pothuajse 50% të fondeve në dispozicion të Buxhetit të Shtetit;

-Parandalimi dhe goditja e rasteve të evazionit fiskal është një atribut i administratës doganore me interes të gjerë publik edhe me ndikimin të padiskutueshëm në të ardhurat publike;

-Kufizimi i konkurrencës së pandershme dhe mbrojtjes së konsumatorit është një tjetër element i rëndësishëm me interes publik;

Për sa sipër këto elemente justifikojnë kufizimet në të drejtat e individëve për të ankimuar vendimet e administratës doganore.

Kufizimet e së drejtës së aksesit në gjykatë janë plotësisht në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës, pasi janë bërë me ligj, janë proporcionale, në raport me gjendjen që ka diktuar adoptimin e tyre dhe nuk cenojnë thelbin e së drejtës.

Kodi Doganor është hartuar në bashkëpunim me misionet e specializuara për të dhënë asistencë në fushën doganore të Bashkimit Europian dhe është në përputhje me Kodin Doganor Komunitar.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave tërheq vëmendjen e Gjykatës se aktet e autoriteteve doganore mund të kundërshtohen në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm duke goditur titullin ekzekutiv dhe se kjo e drejtë e palës ankuese nuk i nënshtrohet asnjë lloj kufizimi, si rrjedhim nuk jemi para një rasti të kufizimit të së drejtës së ankimit.

III

1. Lidhur me legjitimimin e kërkuesit

E drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin si një element thelbësor të saj edhe të drejtën për t'iu drejtuar një gjykate të pavarur dhe të paanshme. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës garantohet nga neni 42 i Kushtetutës, si edhe nga nenet 6/1 dhe 13 i KEDNJ.

Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar edhe më parë në jurisprudencën e saj kushtet kur një gjykatë mund të ushtrojë të drejtën e kontrollit incidental dhe të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për zgjidhjen e një konflikti të natyrës kushtetuese, ndërmjet një norme ligjore dhe urdhërimit të normës kushtetuese.

Në vendimin nr. 2, datë 3.02.2010 Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar disa kushte që duhet të respektohen nga Gjykata referuese gjatë ushtrimit të kontrollit incidental. Gjykata është shprehur si më poshtë vijon: "*Së pari, gjykata ose gjyqtari, gjatë një procesi gjyqësor duhet të përcaktojë/identifikojë ligjin që zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete (lidhjen e drejtpërdrejtë); së dyti, duhet të parashtrojë arsye serioze për jokushtetutshmërinë e këtij ligji (të një ose të disa dispozitave të ligjit) duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës.*"

Në rastin e kontrollit incidental, gjyqtari i çështjes detyrohet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese pasi ai gjendet në pamundësi për të ushtruar funksionet e veta ligjore për arsye se ka dy detyrime. Nga njëra anë ai ka detyrimin të japë drejtësi dhe të zgjidhë në përputhje me ligjin çështjet e shtruara para tij, kurse nga ana tjetër, ai ka detyrimin për të respektuar Kushtetutën dhe parimin e hierarkisë së normave sipas të cilit Kushtetuta ka epërsi ndaj të gjitha normave të tjera juridike.

Për sa më sipër Gjykata çmon se është detyrë e çdo gjyqtari që të vlerësojë nëse palëve në proces u garantohet një e drejtë efektive e aksesit në gjykatë dhe, nëse *prima facie* konstaton se një normë ligjore i kufizon në mënyrë të padrejtë njërës prej palëve mundësinë e aksesit në

gjykatë, atëherë ai është i legjitimuar të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, pasi nuk mund të përmbushë detyrimin ligjor që buron jo vetëm nga Kushtetuta por edhe nga KEDNJ.

Këtë qëndrim ka mbajtur Gjykata Kushtetuese edhe në vendimin e saj nr.5, datë 6.03.2009, ku përcaktohet se gjyqtari referues mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, nëse argumenton një lidhje të drejtpërdrejtë dhe të domosdoshme ndërmjet kushtetutshmërisë së ligjit objekt shqyrtimi dhe zgjidhjes së çështjes konkrete të shtruar para tij.

Posaçërisht lidhur me vendimet administrative, GJEDNJ shprehet se palët kontraktuese duhet të përcaktojnë procedura ligjore të qarta, në bazë të së cilave, vendimet administrative të mund të ankimohen para një gjykate të pavarur dhe të paanshme (shih Albert dhe Le Compte kundër Belgjikës, 10.02.1983). Ndërsa në vendimin për çështjen Kreuz kundër Polonisë GJEDNJ shprehet se e drejta e aksesit në gjykatë duhet të jetë një e drejtë efektive dhe jo formale. Në këtë çështje GJEDNJ merrte në shqyrtim barrierat financiare për t'iu drejtuar gjykatës dhe përcaktonte se këto barriera duhet të analizohen rast pas rasti, në përputhje me mundësitë reale që ka paditësi dhe jo të merret në shqyrtim një mundësi abstrakte për të paguar nga ana e personit që kërkon të vërë në lëvizje gjykatën.

Mekanizmi i përshkruar nga GJEDNJ është i njëjtë me atë të parashikuar nga neni 158/a i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, në bazë të së cilit gjyqtari ka mundësinë të përjashtojë nga parapagimi i taksës mbi aktet dhe shpenzimet e tjera gjyqësore palën ndërgjygjëse që është në pamundësi për të përballuar këtë barrë financiare që mbart pala që vë në lëvizje gjykatën.

Gjykata Kushtetuese (më poshtë "Gjykata"), nisur nga sa sipër, çmon se gjyqtari i vetëm legjitimohet për të ushtruar kontroll incidental, lidhur me faktin nëse pika 5 e nenit 289 të Kodit Doganor kufizon në mënyrë antikushtetuese të drejtën e aksesit në gjykatë të shtetasve.

2. Lidhur me themelin e kërkesës, kontrollin e kushtetutshmërisë së nenit 289, pika 5 të Kodit Doganor

Kërkuesi ka pretenduar se dispozita e mësipërme cenon të drejtën për një proces të rregullt ligjor në një nga elementet e saj thelbësore, në të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6/1 të KEDNJ-së.

Gjykata vëren se në çështjen në shqyrtim ballafaqohen dy interesa të mbrojtura nga Kushtetuta, nga njëra anë, e drejta e shtetasve për të pasur një akses efektiv në një proces të drejtë para një gjyqtari të paanshëm dhe të pavarur, garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe, nga ana tjetër, interesi i shtetit për të vjelë në mënyrë efektive detyrimet doganore, qoftë edhe duke kufizuar të drejtën e aksesit të individëve në gjykatë, në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës.

Gjykata, siç ka argumentuar dhe në vendimin e saj nr.16, datë 25.07.2008, vëren se nuk vihet në dyshim që grumbullimi efektiv i detyrimeve që shtetasit kanë kundrejt shtetit përbën një interes të ligjshëm publik, mëse të mjaftueshëm për të justifikuar kufizime të të drejtave të shtetasve, por me kusht që ato të jenë në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës. Një ndërhyrje shtetërore, e cila kufizon të drejta të ligjshme të shtetasve, mund të ndërmerret kur është e domosdoshme dhe nuk ekziston asnjë rrugë tjetër për të mundësuar arritjen e interesave publikë. Ndërhyrja që kufizon të drejtat e shtetasve, në asnjë rast, nuk mund të cenoje thelbin e së drejtës dhe duhet të jetë në përputhje të plotë me situatën që ka diktuar hartimin e normës kufizuese. Gjykata ka argumentuar se duhet një analizë e kujdesshme nga ana e organit vendimmarrës (në rastin konkret, Kuvendit) në lidhje me mjetin e përdorur për të arritur qëllimin e ligjshëm.

Para së gjithash, mjeti i përdorur duhet të jetë efikas, në mënyrë që të mos kemi një cenim a mohim të të drejtave të individëve pa u arritur realizimi i interesit publik, në funksion të së cilit është hartuar norma juridike. Mjeti duhet të jetë i tillë që të shmangë, sa më shumë të jetë e mundur, kufizimet e të drejtave të individëve në raport me rezultatet që kërkohen të arrihen. Ky konkretizim i parimit të proporcionalitetit detyron ligjvënësin që në çdo rast të vërë në balancë përfitimet publike në raport me cenimin e të drejtave të individëve duke pasur si kufizim logjik dhe juridik të përfitimeve publike, thelbin e të drejtës së individëve.

Në vendimin nr.9, datë 2.04.2003, Gjykata Kushtetuese shprehet se dispozitat objekt

kërkese kushtëzojnë të drejtën e ankimit me pagimin paraprak të vlerësimit tatimor, gjë që përbën kufizim të kësaj të drejte. Po në këtë vendim thuhet, se si çdo e drejtë subjektive, edhe e drejta e ankimit nuk e përjashton mundësinë që ligjvënësi të vendosë kufizime në ushtrimin e saj për të mbrojtur një interes publik ose të drejtat e të tjerëve, por këto duhet të bëhen me kusht që të garantojnë zbatimin e urdhërimeve të parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës, pra që kufizimi të bëhet me ligj, të bëhet në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar, të mos cenoje thelbin e së drejtës dhe të mos tejkalojë kufizimet e parashikuara në KEDNJ.

Nisur nga sa më sipër Gjykata analizoi faktin nëse vjelja e detyrimeve tatimore mund të arrihej pa vendosur kufizime të aksesit të individëve për t'iu drejtuar gjykatës, të cilat mund të prekin thelbin e së drejtës. Duke qenë se nga ana e subjekteve të interesuara është pretenduar se masat e marra kanë për qëllim rritjen e efikasitetit lidhur me vjeljen e detyrimeve që individët kanë ndaj organeve shtetërore, Gjykata vëren se legjislacioni administrativ në fuqi u jep mundësinë organeve doganore të bëjnë të mundur vjeljen efektive të detyrimeve, pa kufizuar të drejtën e aksesit në gjykatë të shtetasve.

Në Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë thuhet se ekzekutimi i detyrimeve të parashikuara në aktin administrativ mund të bëhet forcërisht nga administrata, pa qenë nevoja për t'iu drejtuar gjykatës, me kusht që ekzekutimi të bëhet në përputhje me kërkesat e ligjit (shih nenin 130).

Ndërsa në nenin 138 të këtij Kodi parashikohet se ankimi administrativ pezullon zbatimin e aktit administrativ me përjashtim të rastit kur akti administrativ synon mbledhjen e taksave, tatimeve dhe të ardhurave të tjera buxhetore.

Në këto kushte Gjykata arrin në përfundimin se organet doganore i kanë të gjithë tagrat që të veprojnë me anë të ekzekutimit të detyruar kundrejt debitorëve të tyre, të cilët edhe nëse ankohen, nuk kanë të drejtë të përfitojnë pezullimin e ekzekutimit kundrejt pasurisë së tyre, si pasojë e ankimit administrativ ose gjyqësor. Pikërisht për këto arsye Gjykata, ashtu si dhe në rastin e gjobave tatimore (*shih vendimin nr.16, datë 25.07.2008*), vlerëson se objektivi i ligjshëm shtetëror për të rritur efektivitetin e vjeljes së detyrimeve doganore mund të realizohet pa cenuar të drejtën e individëve për t`iu drejtuar gjykatës.

Të njëjtin mjet juridik, pra ekzekutimin forcërisht të vendimeve të autoriteteve doganore, pa pezulluar këtë ekzekutim në rastin e ankimit e gjejmë edhe në Rregulloren (EEC) No.2913/92 e cila krijonte Kodin Doganor Komunitar.

Palët e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, kanë pretenduar se neni 289/5 është i harmonizuar me Kodin Doganor Komunitar. Gjykata pasi shqyrtoi dispozitat e këtij Kodi arriti në përfundimin se mbështetja në Kodin Doganor Komunitar për të justifikuar kufizimet e aksesit të shtetasve në gjykatë është fryt i një interpretimi të gabuar të Kodit Komunitar Europian.

Në preambulën e Kodit Doganor Komunitar thuhet se në mënyrë që të sigurohet një balancë ndërmjet nevojës së autoriteteve doganore, për të garantuar një aplikim korrekt të legjislacionit doganor në njërën anë dhe të drejtës së tregtarëve për t'u trajtuar në mënyrë të drejtë në anën tjetër, autoriteteve të mësipërme duhet t'u garantohen *inter alia* fuqi të zgjeruara kontrolli dhe tregtarëve të mësipërm e drejta e ankimit (shih paragrafin 9).

Konkretisht, e drejta e ankimit, siç pranon edhe Këshilli i Ministrave në parashtrimet e veta, rregullohet në titullin VIII të Kodit Doganor Komunitar, në nenin 243 të të cilit thuhet se: "Çdo person do të ketë të drejtën e ankimit ndaj vendimeve të autoriteteve doganore, të cilat lidhen me zbatimin e legjislacionit doganor dhe që kanë të bëjnë me ankuesin, drejtpërsëdrejti dhe në mënyrë individuale."

Ndërsa në nenin 244 të këtij Kodi, parashikohet se autoritetet doganore, gjithsesi, do të ndërpresin zbatimin e vendimit të ankimuar, plotësisht ose pjesërisht, kur kanë arsye të besojnë se vendimi bie në kundërshtim me legjislacionin doganor, ose në rastet kur është për t'u pasur frikë se një dëm i pariparueshëm mund t'u shkaktohet subjekteve të prekura nga vendimi.

Këto dispozita duhen shqyrtuar në raport edhe me formulimin e nenit 232 të Kodit, sipas të cilit kur shuma që përbën detyrimin nuk është paguar në afatin e caktuar, autoritetet doganore do të ndërmarrin të gjitha hapat e mundshëm të lejuar nga legjislacioni në fuqi, përfshirë ekzekutimin e detyrueshëm, për të siguruar përmbushjen e detyrimit.

Qëllimi i këtyre dispozitave është që t'u japin mundësinë autoriteteve doganore që të bëjnë sa më efikase vendimet e tyre dhe mënyra më e mirë për të bërë këtë të fundit është ekzekutimi me forcë i sendeve në posedim të kreditorit. Me fjalë të tjera, autoritetet doganore nuk pengohen të sekuestrojnë mallrat e debitorit të gjendura në posedimin e tyre edhe pse debitori mund të ketë paraqitur një ankim administrativ pranë autoriteteve doganore ose pranë autoritetit gjyqësor.

Për sa sipër Gjykata vlerëson se kushti i vendosur në nenin 289, pika 5 të Kodit Doganor për pagimin e gjobës për të pasur akses në gjykatë përbën një kufizim jo proporcional dhe për pasojë, një ndërhyrje të pajustifikuar në të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42, pasi kufizimet e parashikuara nuk janë në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja "a", 134, pika 1, shkronja "d" të Kushtetutës, si dhe të neneve 68, 69 dhe 70 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të pikës 5 të nenit 289 të Kodit Doganor, vetëm në pjesën ku thuhet: "...apeluesi duhet të paguajë pjesën e mbetur prej 60 për qind të gjobës."

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Kujtim Puto, Fehmi Abdiu, Petrit Plloçi, Sokol Berberi, Sokol Sadushi.

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo (kryetar), Vitore Tusha, Xhezair Zaganjori, Admir Thanza

MENDIM PAKICE

Jemi për rrëzimin e kërkesës për arsyet e mëposhtme:

Kushti i vendosur në nenin 289, pika 5 e Kodit Doganor për pagimin e gjobës për të pasur akses në gjykatë nuk përbën kufizim jo proporcional dhe ndërhyrje të pajustifikuar në të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, siç arsyeton shumica.

E drejta kushtetuese e individëve për t'iu drejtuar gjykatës nuk kufizohet nga përmbajtja e nenit të kundërshtuar për faktin, se subjektet e interesuara, disponojnë edhe mjete/mundësi të tjera procedurale për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Në këtë kuptim, neni i kundërshtuar duhet lexuar si pjesë përbërëse e tërësisë së normave të Kodit Doganor dhe jo i veçuar prej tyre. Kështu, neni 245 i Kodit Doganor parashikon se: "*Vendimet e marra nga administrata doganore për zbatimin e masave garantuese dhe/ose për rikuperimin me forcë të borxhit doganor, bëhen tituj ekzekutivë menjëherë sapo ato i njoftohen debitorit. Ekzekutimi i vendimeve të sipërpërmendura bëhet në bazë të dispozitave të parashikuara nga nenet 511 dhe në vazhdim të Kodit të Procedurës Civile. Titujt ekzekutivë të nxjerrë nga administrata doganore, menjëherë sapo mbështeten me urdhrin e ekzekutimit të nxjerrë nga autoritetet gjyqësore kompetente, mund të*

zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga organet e administratës doganore.” Duke qenë se vendimi i administratës, në momentin që i njoftohet debitorit kthehet në titull ekzekutiv, debitori pikërisht në këtë moment, bazuar në rregullimet e nenit 609 të Kodit të Procedurës Civile”... *mund të kërkojë në gjykatën kompetente të vendit të ekzekutimit, që të deklarohet se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm ose se detyrimi nuk ekziston, ose ekziston në një masë më të vogël ose është shuar më pas…Në këto raste, gjykata shqyrton shpejt çështjen dhe mund të vendosë pezullimin e vendimit me ose pa garanci*”. Në kuptim të kësaj norme, debitorit i lind e drejta të ushtrojë padinë për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, gjë që përbën garanci procedurale të tillë, që i mundëson debitorit të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës.

Nga sa më sipër rezulton se neni 289/5 i Kodit Doganor nuk është norma e vetme që, për zgjidhjen e rastit konkret, mundëson apo kufizon aksesin e subjekteve në gjykim. Neni 609 i Kodit të Procedurës Civile u mundëson subjekteve një tjetër mjet procedurial, atë të padisë së pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv për kundërshtimin e vendimeve të marra nga administrata doganore si për zbatimin e masave garantuese dhe/ose për rikuperimin me forcë të borxhit doganor. Kjo padi, e cila është në disponimin e individit që vë në lëvizje gjykatën e zakonshme shqyrtohet nga kjo e fundit pa u kushtëzuar nga ankimi administrativ apo nga rregullimet e nenit 289/5 të Kodit Doganor dhe, në çdo rast, i nënshtrohet parimeve themelore të një procesi të rregullt ligjor.

Nga sa më sipër, mundësia që ka individi për të ngritur edhe padi të tjera të cilat jo domosdoshmërisht kërkojnë vendosjen e garancisë pasurore, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, përbën garanci për ushtrimin e të drejtës për t’ju drejtuar gjykatës.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar), Xhezair Zaganjori, Admir Thanza, Vitore Tusha.